



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Deliverty	31. 05 2021	viti god year	1
Organ /Njësia Orgj./Unit	Nr Prot Nr. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	2749/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.347/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Valentina Kaçandolli Bekteshi, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimin me numër A.nr.1512/19 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.02/535/2014 të datës 04.11.2014, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Rr.“Dëshmorët e Kombit”, p.n. Ferizaj, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.Nr.02/535/2014 e datës 04.11.2014 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 31.07.2014 i Kryetarit të Komunës së Leposaviqit.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me numër 30A/14 të datës 03.03.2014 në Komunën e Leposaviqit në pozitën “Auditor i Brendshëm”, në bazë të Vendimit të datës 31.07.2014 të Kryetarit të Komunës së Leposaviqit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në shërbim civil duke u larguar nga lista e pagave nga muaji gusht 2014. Ankuesi i pa kënaqur me heqjen nga lista e pagave, më datë 02.09.2014 parashtron kërkesën për sqarim të Kryetari i Komunës së Leposaviqit, meqenëse nga ky i fundit nuk ka marr përgjigje, i njëjti, me datë 30.09.2014 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Leposaviqit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Leposaviqit po ashtu nuk ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ndërsa ankuesi për shkak të heshtjes administrative të KZKA-së,

me datë 04.11.2014 parashtron ankesë me numër të protokollit 3303/2014 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor së në mënyrë të paligjshme i është ndërpre marrëdhënia e punës si dhe pezullimi nga të ardhurat personale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me rastin e shqyrtimit të ankesës të datës 04.11.2014, me Vendimin me numër A/02/535/2014 të datë 03.02.2015, është shpall jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit

Ankuesi kundër Vendimit me numër A/02/535/2014 të datë 03.02.2015 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.430/15 të datës 06.02.2019 i pranuar në Këshill me datë 08.03.2019, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit

lute anuluar Vendimin me numër A/02/535/2014 të datës 03.02.2015 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit nuk ka mundur të rishqyrtoj ankesën me numër A.02/535/2014 të datës 04.11.2014, kështu që më datë 15.05.2019 ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative më datë 26.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1512/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 15.05.2019 dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për kërkesën e ankuesit të datës 08.05.2019.

Kolegji për rishqyrtimin e ankesës ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr.430/15 i datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Procesverbalin A.nr.430/15 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimin A.nr.15.12/2019 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesën e datës 08.05.2019 të Avokatit Autorizimin e datës 02.03.2015; Ankesën e ankuesit të datës 04.11.2014 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e ankuesit të datës 03.03.2014; Kontratën e punës të datës 03.03.2014; Kërkesën për aprovimin e vendit të ri të punës të datës 26.02.2014; Unifikimi i pagës/Auditor i Brendshëm i datës 03.12.2010; Marrëveshjen për ndërprerje të marrëdhënies së punës e datës 02.03.2014; Kontratën e punës të datës 02.09.2013; Akt Emërimit e datës 01.02.2012; Kontratën e punës të datës 01.02.2012; Listën e e pagave për muajt mars 2014, prill 2014; maj 2014; qershor 2014; korrik 2014; Kërkesën e ankuesit të datës 02.09.2014 për Kryetarin e Komunës së Leposaviqit; Ankesën e ankuesit të datës 30.09.2014 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Leposaviqit; E-mailin e datës 30.01.2015; Kërkesën e ankuesit të datës 21.08.2014 për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Administratës Publike; Dorëzim-pranimi i formularëve në sektorin e listë-pagesave të datës 21.08.2014; Përgjigjen e datës 31.12.2014 të Ministrisë së Administratës Publike/Departamenti i Administrimit të Shërbimit Publik për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin më numër P2002/03S; Kërkesën e datës 19.12.2014 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Administratës Publike si dhe Përgjigjen në ankesë te datës 22.11.2014 nga organi i punësimit faqe 1/2.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe duke bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.430/15 të datës 06.02.2019 dhe Aktgjykimin me numër A.nr.1512/19 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, si dhe pas administrimit të të gjitha provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi posedon Akt Emërim me Nr.30A/13 të datës 03.03.2014, me të cilin i njëjti ka pozitën e punës Auditor i Brendshëm në Komunën e Leposaviqit, si nëpunës i karrierës pa afat dhe së gjatë periudhën mars-korrik 2014 i njëjti ka qenë në listën e pagave të Punëtorëve të Komunës së Leposaviqit.

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimor të ankuesit, i cili pretendon së Kryetari i Komunës së Leposaviqit, në mënyrë të paligjshme i ka ndërpre marrëdhënia e punës dhe e ka pezulluar nga të ardhurat personale, duke shtuar me tej se ankuesi posedon kontratë të rregullt pune.

Komuna e Leposaviqit në përgjigjen në ankesë të datës 22.11.2014, ka theksuar së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, sepse emërimi i ankuesit si Auditor i Brendshëm është bërë pa asnjë procedurë të pranimit në punë ashtu siç është përcaktuar me Ligjin e Shërbimit Civil të Kosovës, andaj si rezultat i kësaj Kryetari i Komunës ka ndërprerë marrëdhënien e punës së dhe të njëjtin e ka larguar nga lista e pagave. Me tej, shton se ankuesi asnjëherë s'ka filluar dhe nuk ka punuar fare në Komunën e Leposaviqit si Auditor i Brendshëm.

Kolegji gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës vëren se ankuesi ka qenë i punësuar "Drejtor i Sektorit të Arsimit" në Komunën e Leposaviqit, ku i njëjti me datë 02.03.2014 ka lidh marrëveshje me Komunën e Leposaviqit respektivisht me Drejtorin e Shërbimit Juridik të kësaj komune, përmes së cilës marrëveshje palët janë pajtuar që ankuesi të sistemohet në ndonjë pozitë të lirë në kuadër të shërbimit civil të Komunës së Leposaviqit. Në pajtim me këtë marrëveshje, Komuna e Leposaviqit me datë 03.03.2014 i ka lëshuar ankuesit Akt Emërimin në pozitën e Auditorit të Brendshëm në Komunën e Leposaviqit.

Po nga shtjellimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil (me tej DASHC) pranë Ministrisë së Administratës Publike, përmes shkresës së datës 31.12.2014, ka konfirmuar së DASHC-ja nuk ka pranuar asnjë kërkesë nga Komuna e Leposaviqit dhe nuk ka miratuar ndonjë kërkesë për shpallje të konkursit lidhur me pozitën e ankuesit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 3 paragrafi 2 ku përcaktohet se: *Nëpunësit civil punësohen në bazë të meritës, pasi t'i jenë nënshtruar procedurës përzgjedhëse, e përcaktuar në bazë të këtij ligji dhe akteve përkatëse nënligjore*, ndërsa neni 19 i po të njëjtit ligj ka paraparë se: *Nëpunësit civilë themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkresë të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike,..,* dhe si rrjedhojë ka konstatuar se pranimi në Shërbim Civil behët vetëm përmes procedurës së caktuar të rekrutimit. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh se emërimi i ankuesit në pozitën

e Auditorit të Brendshëm në Komunën e Leposaviqit, është bërë pa ndonjë procedurë pranimi, Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Bazuar në nenin 65 paragrafi 1 pika a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se drejtoret komunale nuk kanë statusin e nëpunësit civil, andaj emërimi me automatizëm i ankuesit në shërbimin civil gjegjësisht pa zbatim të procedurës së rekrutimi, është në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht Nenit 51, një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nëse akti i tillë është nxjerrë me ndonjërin nga shkeljet e përcaktuara me nenin 52 të të njëjtit Ligj e me të cilin përcaktohet se: 1.Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:...; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; ...1.5. është në kundërshtim me ligjin material; ... e mbi këtë bazë si dhe duke u nisur nga konstatimi si me lartë se emërimi i ankuesit në pozitën e Auditorit të Brendshëm në Komunën e Leposaviqit, është bërë pa procedurë rekrutimi, Kolegji vlerëson se vendimi i atakuar me ankesë është në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.430/15 të datës 06.02.2019 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimin me numër A.nr.1512/19 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.347/2021

Valentina Kaçandolli BEKTESHI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Kryetarit të Komunës së Leposaviqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Leposaviqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

